



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 421/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të dëmtimit të posterit, në seancën e panelit të mbajtur me 12.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REUZOHET si e pabazuara ankesa e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 10.12.2010, nga subjekti politik AAK, me te cilën pretendohet se më datë 08.12.2010, në hyrje te Suharekës, subjekti politik PDK, ka dëmtuar posterin e subjektit politik AAK, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur 2 (dy) fotografi si dëshmi. Parashtruesi i ankesës propozon qe të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesa është e pabazuar.

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë janë të pabazuara nga shkak se nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme për të besuar se kanë ndodhur shkelja e tillë nga subjekti politik PDK. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 421/2010 më datën 12.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

